



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS SLLAVO-BALLKANIKE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS**  
**Komunikimi Ndërkulturor**

**Ngarkesa:** 40 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

**Semestri kur zhvillohet:** Viti I / Semestri II

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Master – Mësuesi

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

Lënda Komunikimi Ndërkulturor në gjuhën turke është një lëndë e detyrueshme e fushës së gjuhësisë që është e parashikuar në programin mësimor të ciklit të dytë, master, me katër kredite, zhvillohet në raportin 2 leksione dhe 2 seminare në javë. Është një lëndë e rëndësishme që i njeh studentët me elemente kulturore në përgjithësi dhe elementet e kulturës turke në veçanti. Në këtë cikël leksionesh të përzgjedhura, si dhe në literaturën e detyrueshme për t'u lexuar, studenti do të njihet me çështje të komunikimit ndërpersonal dhe ndërkulturor. Do të ndalemi në mënyrë të veçantë në çështje të perceptimit të realitetit jashtëgjuhësor, në çështje të diversitetit kulturor, të komunikimit.

***Objektivat e përgjithshme lëndore:***

- Të marrë njohuritë bazë të lëndës së Komunikimit Ndërkulturor.
- Të njohë elementë të komunikimit kulturor.
- Të perceptojë realitetin jashtëgjuhësor.
- Të kuptojë diversitetin kulturor.

***Objektivat specifike lëndore:***

- Të njohë procesin e komunikimit, mesazhin, qëllimin e mesazhit,
- Të kuptojë rëndësinë e komunikimit.
- Të mbledhë informacion nëpërmjet mjeteve të komunikimit.